



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti I Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Mësimi në gjuhën e zgjedhur zyrtare

NUMËR :10/2007

DATA: 6.04.2007

Në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007 si dhe në bazë të nenit 19.2,19.3,19.4,24.1 të Ligjit mbi Gjuhët në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT) nxjerr Udhëzim Administrativ për mësim në gjuhën e zgjedhur zyrtare.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është përcaktimi i dispozitave për zbatimin e ligjit të gjuhëve, mundësinë e mësimin në gjuhën e zgjedhur zyrtare të komunitetit ku gjuha e tyre e zgjedhur nuk përdoret në asnjë shkollë, mbajtja e shënimeve në dokumentacionin shkollor(lëshimin e librezës,dëftesës, diplomës etj.) sistemimin e nxënësit dhe kushtet e punës.

Neni 2

Deklarimi i prindit –nxënësit

Për komunitetin gjuha e zgjedhur e të cilit nuk përdoret në asnjë shkollë, nxënësi ose prindi i tij duhet të deklarohet me shkrim për gjuhën e zgjedhur zyrtare.

Neni 3

Paraqitja dhe përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa i drejtohet drejtorit të asaj shkolle në të cilën nxënësi dëshiron të shkollohet .
2. Kërkesa duhet të përmbajë :
 - a) emrin dhe mbiemrin e nxënësit;
 - b) datën dhe vendin e lindjes;
 - c) emrin e prindit;
 - d) adresën e vendbanimit;
 - e) numrin kontaktues të prindit, dhe
 - f) në fund nxënësi ose prindi deklarohe për gjuhën e zgjedhur zyrtare.

Neni 4

Dokumentacioni

Nxënësi ose prindi i tij deklarohe me shkrim për gjuhën në të cilën dëshiron të mbahet dokumentacioni shkollor.

Neni 5

Afatet e parashtrimit të kërkesës

1. Kërkesa bëhet së paku 60 ditë para fillimit të vitit shkollor respektivisht para regjistrimit në shkollë për nxënësit e klasës së parë të arsimit fillor.
2. Nxënësit të cilët gjatë vitit shkollor kthehen nga diaspora, pasi ta kenë bërë nostrifikimin e dokumentacionit deklarohen me shkrim për gjuhën e zgjedhur zyrtare për mësim.
3. Gjuha e zgjedhur zyrtare duhet te jetë njëra nga gjuhët zyrtare e cila është gjuhë mësimore në shkollat e komunës.

Neni 6

Sistemimi dhe kushtet e punës

Drejtori i shkollës bën sistemimin e nxënësve sipas gjuhës së tyre të zgjedhur.

Neni 7

Drejtori i shkollës

- 1.Drejtori i shkollës në bashkëpunim me DKA siguron kushtet e punës sipas standardeve të shkollës.
- 2.Drejtori i shkollës njofton kandidatët e paraqitur për epilogun e kërkesës.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Agim Veliu, ministër